

20182454572

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15, 30/16 dhe 21/18), në nenin 3 paragrafi (1) pika 3 shlyhet.

Pikat 4 dhe 5, bëhen pika 3 dhe 4.

Në pikën 5-a, e cila bëhet pikë 4-a, numri "5" zëvendësohen me numrin "4".

Pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 bëhen pika 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Neni 2

Në nenin 7 paragrafi (2) shlyhet.

Në paragrafin (3), i cili bëhet paragraf (2), fjalët: "Pas përfundimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, shoqëria" zëvendësohen me fjalën "Shoqëria".

Neni 3

Në nenin 39-x paragrafi (3) fjalët: "paragrafi (8)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (6)".

Neni 4

Në nenin 56-a pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Mjetet e realizuara nga teprica e të hyrave mbi shpenzimet të shpërndara në fondin rezervë të Agjencisë shfrytëzohen për:

a) promovim, organizim dhe nxitje të zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë;

b) zhvillim/përsosje të proceseve afariste dhe sistemit informatik të lidhura me anëtarësinë në fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe me pagesën e pensionit dhe kompensimet pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital, dhe

v) kompensimi i mungesës së mjeteve nëse gjatë vitit paraprak afarist Agjencia bën më shumë shpenzime në raport me të hyrat e realizuara.

(3) Mjetet e realizuara nga teprica e të hyrave mbi shpenzimet e shpërndara në fondin rezervë të Agjencisë ruhen në llogari të veçantë me destinim te banka afariste në Republikën e Maqedonisë."

Neni 5

Neni 56-b shlyhet.

Neni 6

Nenin 58 ndryshohet si vijon:

"(1) Të siguruarit të cilët për herë të parë i qasen sigurimit të detyrueshëm pensional dhe invalidor pas 1 janarit 2019 dhe në datën e qasjes janë më të rinj se 40 vjet, në pajtim me nenin 118 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, janë të obliguar të anëtarësohen dhe të paguajnë kontribute në fondin të detyrueshëm pensional me përzgjedhje personale derisa e kanë cilësinë e të siguruarit në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

(2) Të siguruarit nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar të anëtarësohen në fond të detyrueshëm pensional në afat prej tre muaj duke llogaritur nga data e qasjes në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

(3) Anëtar i fondit të detyrueshëm pensional mund lirisht të kalojë dhe të anëtarësohet në fond tjetër të detyrueshëm pensional.

(4) Agjencia është e obliguar t'i informojë qytetarët për kategoritë të të siguarve të cilët janë të obliguar të anëtarësohen në fond të detyrueshëm pensional, për faktorët të cilët duhet të merren parasysh gjatë miratimit të vendimit për zgjedhje të fondit të detyrueshëm pensional dhe për lidhje të marrëveshjes për anëtarësi me shoqërinë që menaxhon me fond të detyrueshëm pensional.

(5) Kontributet e të siguarve të cilët nuk janë anëtarësuar në fond të detyrueshëm pensional në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, ruhen në llogaritë e veçanta në fond të detyrueshëm pensional në të cilin përkohësisht janë shpërndarë në pajtim me paragrafin (6) të këtij neni, deri në momentin kur i siguari bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional.

(6) Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë përkohësisht i shpërndan të siguarit nga paragrafi (5) të këtij neni në fond të detyrueshëm pensional nga dita e qasjes së tyre në sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor.

(7) Gjatë shpërndarjes së të siguarve në fondet e detyrueshme pensionale në pajtim me paragrafin (6) të këtij neni, Agjencia siguron që numri i të siguarve të cilët shpërndahen në çdo fond të detyrueshëm pensional të caktohet sipas kontributit të fondit të detyrueshëm pensional dhe lartësisë së kompensimit nga neni 98 paragrafi (1) pika a) të këtij ligji të cilin e arkëton shoqëria e cila menaxhon me atë fond të detyrueshëm pensional, në datën të cilën e përcakton Agjencia.

(8) Të siguarit nga paragrafi (1) të këtij neni të cilët nuk do të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësi në afat prej tre muaj nga data e qasjes në sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor, pas përfundimit të atij afati bëhen anëtarë të fondit të detyrueshëm pensional në të cilin kanë qenë të shpërndarë në pajtim me paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni.

(9) Agjencia e përcakton mënyrën e shpërndarjes së të siguarve në fondet e detyrueshme pensionale nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni."

Neni 7

Në nenin 60 pas paragrafit (2) shtohen katër paragrafë të rinj (3), (4), (5) dhe (6), si vijojnë:

"(3) Nëse Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë nuk i bart kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të detyrueshme pensionale menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej pesë ditë pune nga dita e pranimit të kontributeve për shkak të mungesës së të dhënave adekuate, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë është i obliguar në afat jo më të gjatë se tre muaj nga dita e pranimit të kontributeve të sigurojë të dhëna adekuate dhe të kryejë bartje të kontributeve të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të zgjedhur të detyrueshëm pensional tek ruajtësi i pronës.

(4) Kur kontributet i bart pas përfundimit të afatit nga paragrafi (3) i këtij neni, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë është i obliguar gjatë bartjes së kontributeve, të paguajë edhe kompensim për bartje jo në kohë të kontributeve.

(5) Nëse Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë nuk bën shpërndarje të të siguarve nga neni 58 paragrafi (1) të këtij ligji në fondet të detyrueshme pensionale menjëherë por më së voni në afat prej tre muaj pas qasjes së tyre në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, Fondi i sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë është i obliguar gjatë shpërndarjes të të siguarve në fondet e detyrueshme pensionale dhe bartjen e kontributeve të paguajë edhe kompensim për bartje jo në kohë të kontributeve.

(6) Nëse Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë bën bartje të gabuar të kontributit në fond të detyrueshëm pensional, në datën e parë të ardhshme të bartjes pas datës të pranimit të njoftimit për kontribut gabimisht të bartur nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, shoqëria e bart kontributin gabimisht të bartur në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë."

Pas paragrafit (3), i cili bëhet paragraf (7), shtohet paragraf i ri (8), si vijon:

"(8) Agjencia e përcakton mënyrën e bartjes së kontributeve nga paragrafët (3) dhe (6) të këtij neni dhe mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së kompensimit nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni."

Neni 8

Neni 62 shlyhet.

Neni 9

Në nenin 64-a paragrafi (1) pika b) shlyhet.

Pikat v) dhe g) bëhen pika b) dhe v).

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

"(3) Kur i siguruari gabimisht është shpërndar në fond të detyrueshëm pensional nga ana e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, në datën e parë të ardhshme të bartjes pas ditës së pranimit të njoftimit për shpërndarje të gabuar nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, shoqëria e bart shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaria e të siguruarit gabimisht të sistemuar në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë. Pas bartjes së kryer të mjeteve, shoqëria e mbyll llogarinë individuale të anëtarit.

(4) Agjencia e përcakton mënyrën e bartjes së mjeteve nga paragrafi (3) të këtij neni."

Neni 10

Në nenin 65 paragrafi (3) fjalët: "paragrafi (7)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (5)".

Neni 11

Në nenin 66 paragrafi (4) fjalët: "paragrafi (7)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (5)".

Neni 12

Në nenin 66-a paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Shuma e përgjithshme e mjeteve nga llogaria e anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional të cilit i pushon anëtarësia për shkak të ndryshimit të bazës së sigurimit në pajtim me nenin 118 paragrafi (4) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, barten në Fondin të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, pas përfundimit të afatit prej 90 ditë nga dita e ndryshimit të bazës së sigurimit të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional."

Neni 13

Në nenin 68 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Kontributet për të cilat Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë nuk mund të përcaktojë kujt i takojnë ruhen në llogarinë të paidentifikuar në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë derisa nuk përcaktohet pronësia e atyre mjeteve. Kontributet të paguara në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë për të cilat ka paqartësi për të dhënat përcjellëse, ruhen në llogarinë e pashpërndarë me nënllogaritje individuale në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë."

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë është i obliguar në afat jo më të gjatë se tre muaj nga dita e pranimit të kontributeve të sigurojë të dhëna adekuate dhe të bëjë bartje të kontributeve të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë të fondeve të detyrueshme pensionale të përzgjedhura të ruajtësi i pronës.

(3) Kur kontributet i bart pas përfundimit të afatit nga paragrafi (2) të këtij neni, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë është i obliguar gjatë bartjes së kontributeve, të paguajë edhe kompensim për bartje jo në kohë të kontributeve."

Në paragrafin (2) i cili bëhet paragraf (4) fjalët: "paragrafi (7)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (5)".

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (5) shtohet pikë e re g), si vijon:

"g) mënyra e bartjes së kontributeve dhe mënyra e llogaritjes dhe pagesës së kompensimit nga paragrafi (3) të këtij neni;"

Pikat g) dhe d) bëhen pika d) dhe gj).

Neni 14

Në nenin 69 paragrafi (1) pas pikës b) shtohet pikë e re v), si vijon:

"v) përkohësisht i sistemon të siguruarit në fond të detyrueshëm pensional në pajtim me nenin 58 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji."

Pikat v), g), d), gj), e) dhe zh) bëhen pika g), d), gj), e), zh) dhe z).

Neni 15

Pas nenin 70 shtohet nen i ri 70-a, si vijon:

"Neni 70-a

(1) Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë paguan kompensim për kryerje të punëve të cilat i janë përcaktuar me këtë ligj.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) të këtij neni paraqet kompensim mujor në ngarkim të shoqërive pensionale në shumë prej 0,1% nga çdo kontribut të paguar në muajin paraprak në fondet e detyrueshme pensionale me të cilët menaxhojnë."

Neni 16

Në nenin 71 pika në fund të fjalisë shlyhen dhe shtohen fjalët: "edhe për sistemimin e të siguruarve në fondet të detyrueshme pensionale në pajtim me nenin 58 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji."

Neni 17

Në nenin 95 paragrafi (1) fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

"Ky njoftim, pas pëlqimit paraprak nga anëtari, në vend në formë me shkrim mund të dorëzohet edhe në formë elektronike."

Neni 18

Në nenin 125 paragrafi (5) numri "62" zëvendësohet me numrin "61".

Neni 19

Në nenin 133 paragrafi (1) pika 1) shlyhet.

Pikat 2) dhe 2-a, bëhen pika 1) dhe 2).

Neni 20

Në nenin 136-v paragrafi (1) në pikën 1) pas fjalëve: "pika v)" shtohen fjalët: "dhe g)".

Neni 21

Neni 139 shlyhet.

Neni 22

(1) Anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional i lindur para 1 janarit 1967, i pushon anëtarësia në fond të detyrueshëm pensional më 1 janar 2019. Me pushimin e anëtarësisë, i siguruari mbetet i siguruar vetëm në sigurimin pensional rrjedhës të financiar të bazuar në solidaritet të gjeneratës.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, anëtari i fondit të detyrueshëm pensional i lindur para 1 janarit 1967, i cili është qasur në sigurimin të detyrueshëm pensional me financim kapital me përzgjedhje personale dhe është bërë anëtar i fondit të detyrueshëm pensional, në pajtim me nenin 58 paragrafi (3) të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15, 30/16 dhe 21/18), ka të drejtë të zgjedh ta ndërpres ose vazhdojë anëtarësinë në shtyllën e dytë pensionale me deklaratë me shkrim për pushim ose vazhdim të anëtarësisë në fondin të detyrueshëm pensional, më së voni deri më 30 shtator 2019. Nëse anëtari, gjatë rrjedhës së kohëzgjatjes në këtë afat nuk jep deklaratë për vazhdim të anëtarësisë në fond të detyrueshëm pensional, pas përfundimit të afatit i pushon anëtarësia në fond të detyrueshëm pensional. Anëtarit i cili jep deklaratë për pushim të anëtarësisë në fond të detyrueshëm pensional para 30 shtatorit 2019, anëtarësia i pushon në datën e dhënies së deklaratës.

(3) Për anëtarët të cilëve u pushon anëtarësia në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, shoqëria e bart shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaria e anëtarëve në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, në afat prej gjashtë muaj duke filluar nga prej 1 janarit 2019, në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia. Pas bartjes së kryer të mjeteve, shoqëria e mbyll llogarinë individuale të anëtarit.

(4) Për anëtarët nga paragrafi (2) të këtij neni, llogaria individuale në fondin e detyrueshëm pensional mbetet e hapur dhe ato mjete investohen në mënyrë të barabartë si edhe mjetet të tjera të fondit të detyrueshëm pensional deri në datën e dhënies së deklaratës për pushim të anëtarësisë përkatësisht deri në skadim të afatit nga paragrafi (2) të këtij neni. Pas pushimit të anëtarësisë në matim me paragrafin (2) të këtij neni, shoqëria e bart shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaria e anëtarit në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia. Pas bartjes së kryer të mjeteve, shoqëria e mbyll llogarinë individuale të anëtarit.

Neni 23

Të siguruarve të cilët kanë fituar anëtarësi në sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital në pajtim me nenin 58 të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15, 30/16 dhe 21/18) dhe të cilët janë të lindur pas 1 janarit 1967, u vazhdon anëtarësia në sigurimin të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 24

(1) Anëtarëve të fondit të detyrueshëm pensional të cilit deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, gjatë sigurimit janë pajisur me cilësinë e të siguruarit në pajtim me nenin 11 pika 9 dhe 15 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ose gjatë sigurimit kanë pasur stazh të sigurimit i cili llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar, u pushon anëtarësia në sigurimin të detyrueshëm pensional me financim kapital më 1 janar 2019.

(2) Për anëtarët të cilëve u pushon anëtarësia në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, shoqëria e bart shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaria e anëtarëve në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, në afat prej gjashtë muaj duke filluar nga prej 1 janarit 2019, në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia. Pas bartjes së kryer të mjeteve, shoqëria e mbyll llogarinë individuale të anëtarit.

Neni 25

(1) Të siguruarit të cilët në pajtim me nenin 58 të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13,

44/14, 192/15, 30/16 dhe 21/18) janë anëtarë të detyrueshëm të fondeve të detyrueshme pensionale, por të cilët deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë nuk i ka sistemuar në fondet të detyrueshme pensionale në pajtim me nenin 69 paragrafi (1) pika v) të këtij ligji, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë është i obliguar gjatë sistemimit të tyre në fondet e detyrueshme pensional bartjes së kontributeve për ata të siguruar të paguara për periudhë deri në datën e pagesës së kontributit në sigurimin të detyrueshëm pensional me financim kapital deri në ditën e sistemimit të tyre, të paguajë kompensim për bartje jo në kohë të kontributeve.

(2) Mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së kompensimit nga paragrafi (1) të këtij neni e përcakton Agjencia.

Neni 26

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12), neni 1 shlyhet.

Neni 27

Rregullat nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 28

Autorizohet Komisioni Juridik-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2019.